



**40 HADITHE
RRETH
VËLLAZËRISË NË ISLAM**

Tiranë, 2022

Titulli: *40 hadithe rreth vëllazërisë në Islam*

I përzgjedhi dhe i përktheu: **Sabrie Feza**

Recensent: **Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Korrektor fetar: **Vjollca Karaj**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie Feza**

Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: Shoqata Flladi – Tiranë, 2022



VËLLAZËRIA NË ISLAM

**Me emrin e Allahut, Të
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin Muhamed, zotërinë e krijesave dhe vulën e profetëve, mbi Ehli Bejtin e tij të pastër e të dëlirë, mbi shokët e tij të zgjedhur dhe mbi të gjithë të dërguarit e Allahut.



Es selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu!

Paqja, mëshira e Allahut dhe mirësitë e Tij
qofshin mbi ju!

Kur flasim për vëllazërinë në Islam,
menjëherë na bie ndërmend ajeti kur'anor:
**“Me të vërtetë, besimtarët janë
vëllezër...”**¹ Këtu nuk po flasim për
vëllazëri gjaku, por për vëllazëri në fe. Kjo
vëllazëri nuk duhet të jetë sipërfaqësore,
por e fortë dhe duhet ta ketë vendin në
shpirt e në zemër. Vëllazëria nuk duhet të
jetë me qëllime interesi, por një dashuri e

1 Sure “Huxhurat”, ajeti 10.



vërtetë, që shprehet me fjalë e vepra të mira.

Vëllazëri e vërtetë është kur t'i do për vëllanë atë që do për vete, kur dëshiron që ai të jetë besimtar i përpiktë, të jetë krenar, i fortë e të sillet mirë. Kur ta këshillosh atë dhe ta mësosh se si të ecë në rrugë të drejtë, duhet të përdorësh metodat më të mira për t'ia arritur qëllimit, në mënyrë që të mos e lëndosh atë.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *"Myslimani është vëlla i myslimanit. Ata janë një dorë e vetme, e përbashkët në krahësim me të tjerët..."* Bashkimi i rrymave ndërmjet besimtarëve duket qartë në fjalët

e urta e dashamirëse të Profetit tonë të nderuar. Ai ka thënë: *“Besimtarët janë si një shpirt i vetëm”*. Profeti më i nderuar i kohëve (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ka quajtur mesazh hyjnor paktin e vëllazërimit. Ai ka thënë: *“Besimtarët janë vëllezër. Kushdo që hyn në grupin e besimtarëve, është vëlla dhe i barabartë me besimtarët e tjerë”*.

Çdo besimtar ka detyra, përgjegjësi dhe angazhime ndaj vëllait të tij në fe, derisa të çojë në vend të drejtën e vëllazërimit. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), armiqësinë e skajshme që kishte ngelur nga periudha e injorancës, e shndërroi në mëshirë e miqësi: **“Ai i pajtoi**



zemrat tuaja.”², thuhet në Kur’anin Famëlartë. Ky pakt vëllazërimi dhe dashurie nuk shtihej në dorë me anë të parave dhe vlerave materiale. Ai kishte ngjyrë hyjnore.

Pasi mbërriti në Medinen e ndritur, hapi i parë që ndërmori Profeti ynë i nderuar, qe futja e ndjenjës së dashurisë dhe të dhembshurisë në mesin e myslimanëve ensarë dhe muhaxhirë. Këtë e bëri duke vëllazëruar një ensar me një muhaxhir. Ky veprim i bekuar ndikoi shumë në forcimin e marrëdhënieve shoqërore, duke zhdukur zakonet e hakmarrjes e të fanatizmit injorant dhe

2 Sure “Ali Imran”, ajeti 103.

duke i zëvendësuar ato me dashurinë, respektin dhe vëllazërinë islame, duke i bërë ata një umet i përbashkët. Islami i zhdukuri të gjitha ngjyrat e epërsisë e të dallimit mbi bazë fisi, race, pozite dhe pasurie.

Individët e shoqërisë islame janë të barabartë në të drejta. Vlerësimi se kush është më i mirë, u bë devotshmëria ndaj Allahut të Madhëruar. Në ajetin 13 të sures “El Huxhurat” thuhet: **“Më i miri ndër ju tek Allahu, është ai që është më i devotshëm....”**

Në suren “Ali Imran” thuhet: **“Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat**



tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër...”³ Në bashkësinë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), mbizotëronte shpirti i vëllazërisë dhe nuk ekzistonte kurrfarë pandersshmërie dhe përçarjeje. Gjatë kohës që ishte gjallë Profeti i Islamit, nuk gjendeshin mosmarrëveshje ndërmjet myslimanëve. Profeti më i nderuar i kohërave (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte vetë shembull, udhërrëfyes dhe sqarues i së vërtetës së fesë. **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që**

3 Sure “Ali Imran”, ajeti 103.

shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”⁴

I Dërguari i Allahut na mëson se vëllazëria është një mirësi nga Allahu i Madhëruar. Ka shumë hadithe të Profetit tonë të nderuar dhe të familjes së tij, të cilat flasin rreth vëllazërisë mes myslimanëve, duke e konsideruar atë një lidhje të fuqishme për unitetin e shoqërisë, për forcimin e marrëdhënieve mes individëve edhe një mundësi për të marrë shpërblim në Ditën e Gjykimit.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ka

4 Sure “El Ahzab”, ajeti 21.



thënë: *“Allahu do ta lartësojë cilindo që vëllazëron një vëlla për hir të Allahut, deri në ato shkallë, të cilat ai nuk mund t’i arrijë me punët që bën”*.⁵

Ndërsa në një rast tjetër thotë: *“Në Ditën e Gjykimit, për një grup njerëzish do të shtrohen karrige rreth Arshit dhe fytyrat e tyre do të jenë të ndritura si hëna e plotë. Atë ditë, kur njerëzit do të jenë të frikësuar, ata nuk frikësohen. Ata janë eulijatë (njerëzit e mirë) e Allahut, të cilët as nuk frikësohen e as nuk zemërohen”*.

- Cilët janë ata, o i Dërguari i Allahut?
- e pyetën të Dërguarin e Allahut (*Paqja*

5 “El Hakaik”, f. 318.



e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

- Do të jenë ata që e donin njëri-tjetrin për hir të Allahut, - u përgjigj Profeti Muhamed.⁶

Pozita më e madhe e vëllazërisë në Islam është ajo për hir të Allahut dhe jo ajo që është për të arritur ndonjë gradë, as për të përfituar diçka e as për të fituar në aspektin financiar.

6 “Ihjaul Ulum”, K.“Rregullat e shoqërimit e të bashkëjetesës”.



Kush duhet për Allahun dhe vëllazëria është për Allahun, e ka arritur qëllimin e duhur.

Përgëzim për ata që duhen për Allahun, për premtimin që u është dhënë nga Allahu i Lartësuar, se do të shpëtojnë në Ditën e Kiametit dhe do të futen nën hijen e Arshit, atë Ditë që nuk ka hije përveç saj. Transmetohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Një njeri kishte vizituar një herë një shok të tij. Allahu i Lartësuar kishte dërguar pas tij një engjëll.

- Ku do të shkosh? – e pyeti engjëlli, kur iu afrua njeriut.

- Dua të takoj një vëlla në këtë fshat, - u përgjigj njeriu.

- Ke ndonjë arsye që do të shkosh te ai?
- e pyeti engjëlli.

- Jo. - i tha njeriu - Unë e dua për hir të Allahut.

- Unë jam dërguar nga Allahu, të të lajmëroj se Allahu të do ashtu siç e deshe ti atë, për hir të Madhërisë së Tij, - i tha engjëlli.

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë fjalët me të cilat i ka folur Allahu: "Dashurinë Time e meritojnë ata që vizitojnë njëri-tjetrin për Mua; ata që ndihmojnë për



hatrin Tim; ata që duan njëri-tjetrin për Mua; ata që u japin të tjerëve për Mua”.⁷

Vëllazëria është këshillim dhe qëndrim pranë njëri-tjetrit në një dynja. Litarët e saj janë të shkurtër dhe kanë nevojë për litarin e Allahut të Madhërishëm. Prandaj, vëllazëria mund të ekzistojë vetëm nëse kapemi fort pas litarit të Allahut të Madhërishëm, drejt të mirës dhe në rrugë të Allahut. **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kur’anin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër.**

7 “Musned ibn Hanbel”, vëll. 4, f. 386.

Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon Shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë”.⁸

Përderisa të gjitha veprimet islame janë për Allahun, atëherë edhe dashuria, edhe urrejtja janë prej bazave të fesë. Në disa hadithe, ato quhen prej bazave të fesë, kur janë për Allahun. Vëllazëria islame nuk është tjetër veçse dashuri mes myslimanëve, për hir të Allahut. Kur’ani e përforcon këtë: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër”**.⁹ Në këtë ajet kur’anor përmendet një rregull, i cili ka fuqinë e një

8 Sure “Ali Imran”, ajeti 103.

9 Sure “El Huxhurat”, ajeti 10.



ligji gjithëpërfshirës për të gjitha kohët dhe vendet. Më tej ajeti vazhdon: **“Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata...”** Ashtu si përpiqeni për të pajtuar mes tyre dy vëllezër të një gjaku, ashtu duhet të mos leni përpjekje pa bërë, por ama, me drejtësi të plotë, për t’i futur besimtarët e përfshirë në konflikt, në rrugën e pajtimit.

Sa e bukur dhe sa shprehëse vjen kjo shprehje, teksa Kur’ani përmend e kujton se të gjithë besimtarët janë vëllezër, se konflikti ndërmjet tyre është konflikt ndërmjet vëllezërish, kështu që në vend të konfliktit, duhet të angazhohemi që të mbjellim paqen dhe pajtimin mes tyre.

Kur njerëzit dëshirojnë të tregojnë lidhjet e tyre të ngushta apo të gjithë ato që u bashkohen në metodikë dhe punë, këta i quajnë thjesht *shok(ë)*. Në të vërtetë, Islami ka shkuar më tej në këtë drejtim. Nivelin e lidhjes dhe të marrëdhënies e ngriti, duke e konsideruar si nivelin e lidhjes më të ngushtë, që mund të ekzistojë midis dy njerëzve. Kjo është marrëdhënia vëllazërore, marrëdhënie që ndërtohet mbi baza të mirëfillta barazie.

Duke u mbështetur në këtë bazë të rëndësishme të Islamit, arrijmë në përfundimin se të gjithë myslimanët, pavarësisht përkatësive fisnore, kombëtare dhe gjuhësore, pavarësisht edhe moshës të tyre, e ndiejnë thellë lidhjen vëllazërore

mes vetes, pavarësisht se disa jetojnë në Lindje dhe disa të tjerët në Perëndim.

Shembull i qartë për këtë është bashkimi i myslimanëve nga pika të ndryshme të botës dhe kryerja e përbashkët e ritualeve të Haxhit në Qendrën e Njësimiit Botëror. Aty shpaloset qartë kjo marrëdhënie e ngushtë, kjo lidhje e harmoni mes ritualit dhe ndjenjave të tyre. Të gjitha këto bashkë, e bëjnë realitet këtë ligjësi të rëndësishme të Islamit.

Me fjalë të tjera, Islami i sheh të gjithë myslimanët si një familje e vetme dhe u drejtohet të gjithë atyre, duke i konsideruar vëllezër e motra, jo vetëm me fjalë e parulla, por edhe me vepra e aksione

të përbashkëta e të ngjashme, si vëllezër e motra që janë.

Te transmetimet e ndryshme islame, gjejmë raste të shumta, që e vërtetojnë dhe e mbështesin këtë parim, veçanërisht për sa i përket pjesës praktike të kësaj tabloje.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në një prej letrave drejtuar djalit të tij, Imam Hasanit (*Paqja qoftë mbi të!*) ka shkruar: *“Sillu me tët vëlla duke ia shfaqur ti respektin e vëllazërisë me të, kur ai e shpërfill; ti t'i afrohesh, kur të të largohet e të jesh ti i mirë me të; kur ai ta ngushtojë dorën¹⁰, ta lirosh ti për të; kur ai të të rrijë ftohtë, të shkosh ti pas tij; kur të sillet ashpër me ty, ti të sillesh butë; kur*

10 Të mos japë, të tregohet shumë i kursyer.



ai të gabojë ndaj teje, t'ia shohësh shfajësimin si do të doje të ta shihte ai, sikur të ishte pronari yt. Por kujdesu, që kjo të mos bëhet vend e pa vend e të mos bësh kështu me njerëz të poshtër, që nuk e meritojnë. Mos e prano armikun e mikut tënd si mik, sepse kjo të bën armik të mikut tënd. Jepi vëllait këshillë të vërtetë, le të jetë e ëmbël a e hidhur. Gëlltite zemërimin si gllënkën që ta jep në fund ëmbëlsinë më të madhe e shijen më të këndshme. Ji i butë me atë që të sillet ashpër, se shumë shpejt do të sillet butë dhe vetë ai me ty, në dashtë Zoti. Trajtoje armikun me fisnikëri, sepse kjo është më e shijshmja e të dyja fitoreve që mund të korrësh mbi të.

Nëse të duhet të ndahesh nga një mik, lër për të një vend bosh në zemër, se mund të

kujtohet një ditë e të rikthehet. Nëse dikush ka mendim të mirë për ty, jepi prova që s'është i gabuar. Mos e neverit interesin e tët vëllai, duke keqpërdorur afërsinë tënde me të, sepse s'do të jetë më yt vëlla, nëse s'ia përfill interesin. Mos ji i ashpër e i paduruar me njerëzit e familjes. Mos i shko pas atij që të largohet. Mos e lër tët vëlla të këmbëngulë në shpërfilljen e vëllazërisë më shumë se sa ti në respektimin e saj, prandaj kaloja duke i bërë mirë për të keqen që të bën. Mos u trondit shumë nga padrejtësia që të bëhet, se ajo është në dëm të të padrejtit, ndërkohë që ty të sjell dobi. Nuk mund t'ia shpërblesh me ligësi atij që të ofron mirësi".¹¹

¹¹ "Kulmet e fjalës", f. 167-168.

Ekzistojnë edhe shumë transmetime në librat e njohur islamë të haditheve, që lidhen me të drejtat e besimtarit ndaj vëllait të tij mysliman, me të drejtat e besimtarëve ndaj njëri-tjetrit, me shpërblimin që rezervohet për vizitën e vëllezërve besimtarë, përshëndetja dhe përqafimi, kur kujtojnë njëri-tjetrin, kur fusin lumturi në zemrat e njëri-tjetrit, kur zgjidhin hallet e njëri-tjetrit, kur bëjnë të pamundurën për t'ia hequr njëri-tjetrit ankthin, trishtimin dhe mërzinë, kur ushqejnë të paushqyerin, kur veshin të zhveshurin, kur nderojnë dhe respektojnë nevojtarin, dhe jo më pak e rëndësishme, kur luten për të, pasi i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ka thënë: *"Kur myslimani lutet për vëllanë e tij, pa ditur*

gjë (ky i fundit), lutja pranohet. Tek koka e lutësit qëndron një engjëll i ngarkuar të thotë, pas çdo lutjeje të mirë për vëllanë mysliman: 'Amin, të dhëntë Allahu edhe ty të njëjtën gjë!'"

E Lusim Allahun e Madhëruar, që të na bëjë prej atyre që ua japim hakun që meritojnë, vëllezërit tanë besimtarë!

Sabrie Feza



40 HADITHE
RRETH VËLLAZËRISË
NE ISLAM

Hadithi 1

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Besimtarët janë vëllezër, gjaku i tyre është i barabartë. Ata janë një (të bashkuar) para të tjerëve dhe më i vogli prej tyre mund t’i shpëtojë të gjithë ata”*.¹²

پیامبر خدا صلی الله علیه و آله:

المؤمنون إخوة، تتكافى دماؤهم، وهم يد على من سواهم، يسعى بينهم أدناهم.

مؤمنان برادرند، خونشان برابر است، در برابر دیگران یکدستند و کمترین آنها [می تواند]

کسی را به امان و زندها همه شان درآورد. (الأمالي للمفيد : ۱۳/۱۸۷)

12 “El Amalil Mufijid”, vëll. 13, f. 187.

Hadithi 2

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Besimtari gjen qetësi te besimtari, ashtu siç qetësohet zemra e të eturit me ujën e të ftohtë”.¹³

پیامبر خدا صلی الله علیه و آله:

لَئِىَ الْمُؤْمِنِ لَيَسْكُنَنَّ إِلَى الْمُؤْمِنِ كَمَا يَسْكُنُ قَلْبُ الظَّالِمِ إِلَى الْمَاءِ الْبَارِدِ.
 مؤمن با مؤمن آرام می گیرد، چنان که جگر تشنه با آب سرد.
 (النوادر للراوندي : ۵۸/۱۰۰)

13 “El Neuadiru Lilrauandij”, vëll. 58, f. 100.

Hadithi 3

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Mjafton edhe një vëlla, që nuk ta ka lindur
nëna”.¹⁴

امام علی علیه السلام:

رَبِّ أَخٍ لَمْ تَلِدْهُ أُمَّكَ .

بسی برادر که مادرت او را نزاد.

(غرر الحکم : ۵۳۵۱)

14 “Gururul Hikem”, Hadithi 5351.



Hadithi 4

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “O Kumejl! Besimtarët janë vëllezër me njëri-tjetrin dhe për çdo vëlla, asgjë nuk është më e rëndësishme (më parësore) se vëllai i tij”.¹⁵

امام علی علیه السلام:

يَا كُمَيْلُ ، الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ ، وَلَا شَيْءَ أَكْثَرَ عِنْدَ كُلِّ أَخٍ مِنْ أَخِيهِ .

ای کمیل! مؤمنان با هم برادرند و برای برادر چیزی مقدم تر از برادر نیست.

(بحار الأنوار : ۱/۲۶۹/۷۷)

¹⁵ “Biharul Enuar”, vëll. 77, Hadithi 1, f. 269.



Hadithi 5

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Besimtari është vëlla i besimtarit me babain
dhe nënën e tij”.¹⁶

امام باقر عليه السلام:

المؤمن أخو المؤمن لأبيه وأمه .

مؤمن برادر تنی مؤمن است.

(الكافي : ٢/١٦٦ و ٧)

16 “El Kafi”, vëll. 2, Hadithi 2 dhe 7, f. 166.

Hadithi 6

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, fëmijë të babait dhe të nënës. Nëse ndonjërin prej tyre e mbulon djersa, të tjerët rrinë zgjuar, nuk do të flenë natën (nga mërzia) për të”.¹⁷

امام صادق عليه السلام:

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ بَنُو أَبِي وَأُمِّ، وَإِذَا ضَرَبَ عَلَى رَجُلٍ مِنْهُمْ عِزْقٌ سَهَرَهُ الْآخَرُونَ .
 ههنا مؤمنان برادران یکدیگر و فرزندان یک پدر و مادرند. و اگر رگی از یکی از آنان
 [به ناراحتی] بجنبید دیگران به خاطر او، شب را نمی خوابند.
 (الكافي : ١/١٦٥/٢)

17 “El Kafi”, vëll. 2, Hadithi 1, f. 165.

Hadithi 7

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Besimtari është vëllai i besimtarit, ai është syri
dhe udhërrëfyesi i tij. Ai nuk e tradhton, nuk e
shtyp, nuk e mashtron dhe nuk i premtion, nëse
nuk e mban premtimin”.¹⁸

امام صادق عليه السلام:

المؤمنُ أخو المؤمن، عِيْنُهُ وَدَلِيلُهُ، لَا يَخُونُهُ، وَلَا يَظْلِمُهُ، وَلَا يَشْهَدُ عَلَيْهِ عِدَّةً فَيُخْلِفُهَا
مؤمن برادر مؤمن است، چشم او و راهنمای اوست. به او خیانت نمی کند، به او ستم
نمی کند، کلاه سرش نمی گذارد، و به او و عده ای نمی دهد که بدان عمل نکند.
(الكافي: ۲ / ۳۱۶۶)

18 “El Kafi”, vëll. 2, Hadithi 3, f. 166.



Hadithi 8

Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) ka thënë:
*“Besimtari është vëlla i besimtarit si një trup i vetëm. Sa herë që një gjymtyrë e tij ka dhimbje, ai do ta ndiejë atë dhimbje edhe në pjesët e tjera të trupit të tij, pasi shpirtrat e tyre janë nga një shpirt i vetëm”.*¹⁹

امام صادق عليه السلام:

المؤمن أخو المؤمن كالجسد الواحد، إن اشتكى شيتاً منه وجد ألم ذلك في سائر جسده، و
 أرواحها من روح واحد.

مؤمن برادر مؤمن است، همچون يك پيكر كه هرگاه عضوی از آن به درد آید ديگر
 اندامها آن درد را حس می کنند؛ ارواح آنها از يك روح است (. الكافي : ۴/۱۶۶/۲)

¹⁹ “El Kafi”, vëll. 2, Hadithi 4, f. 166.



Hadithi 9

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Për çdo gjë ka diçka, prej të cilës gjen qetësi.
Një besimtar gjen qetësi te vëllai i tij besimtar,
ashtu siç gjen qetësi zogu në llojin e tij”.²⁰

امام صادق عليه السلام:

لِكُلِّ شَيْءٍ شَيْءٌ يَسْتَرِيحُ إِلَيْهِ، وَلِلْمُؤْمِنِ يَسْتَرِيحُ إِلَى أَخِيهِ الْمُؤْمِنِ كَمَا يَسْتَرِيحُ الطَّيْرُ إِلَى شَجَرِهِ .

هر چیزی با چیزی آرام می گیرد و مؤمن با برادر مؤمن خود آرامش می یابد چنان که
پرندۀ با همجنس خود آرام می گیرد. (بحار الأنوار : ۳۰/۲۳۴/۷۴)

20 “Biharul Enuar”, vëll. 74, Hadithi 30, f. 234.



Hadithi 10

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
*“Rritni numrin e vëllezërve tuaj, sepse në Ditën e Gjykimit do të ndërmjetësohet për çdo besimtar”.*²¹

پیامبر خدا صلی الله علیه و آله:

استکثروا من الإخوان ؛ فإن لكل مؤمن شفاعة يوم القيامة .

br shpar brardan xhud biyfazaid; zira dr ruz qiyamat hr mu’mini ra shfa’ati ast .

(کنز العمال : ۲۴۶۴۲)

21 “Kenzul A’mal”, f. 24642.

Hadithi 11

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Kushdo që zgjedh një vëlla të ri mysliman,
Allahu do t’i ndërtojë një kullë në Xhenet”.²²

پیامبر خدا صلی الله علیه و آله:

مَنْ جَدَّدَ أَخَا فِي الْإِسْلَامِ بَنَى اللَّهُ لَهُ بَرْجًا فِي الْجَنَّةِ .

هر کس برادر مسلمان جدیدی برگزیند ، خداوند در بهشت برای او برجی بنا می نهد .

(الاختصاص : ۲۲۸)

22 “El Ikhtisas”, f. 228.

Hadithi 12

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Njerëzit më të paaftë janë ata që nuk janë në
 gjendje të fitojnë miq dhe vëllezër. Akoma më të
 paaftë janë ata që i humbasin miqtë dhe
 vëllezërit që i kanë fituar”.*²³

امام علی علیه السلام:

أَعَجَزُ النَّاسِ مَنْ عَجَزَ عَنِ اكْتِسَابِ الْإِخْوَانِ ، وَ أَعَجَزُ مِنْهُ مَنْ ضَيَّعَ مَنْ ظَفِرَ بِهِ مِنْهُمْ .
 Na توانترین مردم کسی است که از به دست آوردن دوستان و برادران ناتوان باشد و نا
 توان تر از او کسی است که برادران به دست آورده را از دست بدهد.
 (نهج البلاغة: الحکمة ۱۲)

23 “Nehxhul Belaga”, Urtësia 12.

Hadithi 13

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Një vëlla nga i cili përfitoni, është më i mirë se
një vëlla që vetëm sa shton numrin e vëllezërve
tuaj”.²⁴

امام علی علیه السلام:

أَخٌ تَسْتَفِيدُهُ خَيْرٌ مِنْ أَخٍ تَسْتَرْيِدُهُ .

bradri ke az au بهره بیری بهتر از برادری است که تنها بر شمار برادرانت می افزاید .

(غرر الحکم : ۱۳۶۲)

24 “Gururul Hikem”, f. 1362.

Hadithi 14

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Mos e shtoni numrin e vëllezërve të botës, nëse nuk mund t’i ndihmoni dhe nuk mund t’i plotësoni nevojat e tyre. Ata do të bëhen armiq të tuaj. Shembulli i tyre është si shembulli i zjarrit, nga zjarri i madh digjesh, kurse nga i vogli ngrohesh”.²⁵

²⁵ “Gururul Hikem”, f. 10381.



امام علی علیه السلام:

لَا تَسْتَكْبِرَنَّ مِنْ إِخْوَانِ الدُّنْيَا، فَإِنَّكَ إِنْ عَجَزْتَ عَنْهُمْ تَحَوَّلُوا أَعْدَاءَ وَإِنَّ مَثَلَهُمْ كَمَثَلِ النَّارِ، كَثِيرُهَا يُحْرِقُ وَقَلِيلُهَا يَنْفَعُ .

بر شمار برادران دنیایی میفرای که اگر از برآوردن نیازهایشان درمانده شوی، دشمنی می گردند. حکایت آنان، حکایت آتش است که بسیار آن می سوزاند و کم آن سود می رساند .

(غرر الحکم : ۱۰۳۸۱)



Hadithi 15

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Zgjidhni miq dhe vëllezër të vërtetë dhe
 shtojeni numrin e tyre, sepse ata janë ndihmë
 gjatë begatisë dhe mburojë gjatë fatkeqësisë”.*²⁶

امام علی علیه السلام:

عَلَيْكَ يَا خَوَانَ الصِّدِّيقِ فَاكْثِرْ مِنْ أَكْتَاسِهِمْ؛ فَإِنَّهُمْ عُدَّةٌ عِنْدَ الرِّجَالِ ، وَجُنَّةٌ عِنْدَ الْبَلَاءِ .

در پی دوستان راستین باش و بر شاربشان بیفزای که آنان ذخیره دوران آسایش و

سپر روزگار بلایند!

(الأمالي للصدوق : ۴۸۳/۳۸۰)

26 “Gururul Hikem”, f. 10381.

Hadithi 16

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Kushdo që nuk dëshiron të shtojë numrin e
vëllezërve (të sinqertë), do të jetë në dëm të
tij”.²⁷

امام صادق عليه السلام:
مَنْ لَمْ يَرْغَبْ فِي الْإِسْتِكْمَارِ مِنَ الْإِخْوَانِ ابْتُلِيَ بِالْحُسْرَانِ .
هر که خواهان افزایش شمار برادران نباشد ، به زیان گرفتار می آید.
(تحف العقول : ۳۱۹)

²⁷ “Tuhuful Ukul”, f. 319.

Hadithi 17

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Njeriu shtohet me vëllezërit dhe miqtë e tij”.²⁸

امام صادق عليه السلام:

المرء كثير بأخيه .

انسان به وسیله برادر [و دوستان] خود فزونی می یابد .

(تحف العقول : ۳۶۸)

²⁸ “Tuhuful Ukul”, f. 368.

Hadithi 18

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Dashuria për besimtarin është një nga shkaqet
më të mëdha të besimit”.²⁹

پیامبر خدا صلی الله علیه و آله:

أَوْلَىٰ وَلَوْ أَنَّ الْمُؤْمِنِينَ أَكْثَرُ سَبَبِ الْإِيمَانِ .

هان! دوست داشتن مؤمن یکی از بزرگترین اسباب ایمان است.

(بحار الأنوار : ۷۴/۷/۲۸۰)

29 “Biharul Enuar”, vëll. 74, Hadithi 7, f. 280.



Hadithi 19

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Nëse besimtarët e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut, të Fuqishmit dhe të Lartësuarit dhe janë të pastër (singertë) për hir të Allahut, ata janë si një trup i vetëm: nëse njëri prej tyre ankohet për një vend në trupin e tij, të tjerët e ndiejnë dhimbjen e atij vendi në trupin e tyre”*.³⁰

30 “Biharul Enuar”, vëll. 74, Hadithi 7, f. 281.



پیامبر خدا صلی الله علیه و آله:

أَلَا وَلِئَ الْمُؤْمِنِينَ إِذَا تَحَاتَّبَا فِي اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ وَتَصَافَيَا فِي اللَّهِ كَانَا كَالْجَسَدِ الْوَاحِدِ : إِذَا
اشْتَكَى أَحَدُهُمَا مِنْ جَسَدِهِ مَوْضِعًا وَجَدَ الْآخَرُ أَلَمَ ذَلِكَ الْمَوْضِعِ .
بدانید که اگر مؤمنان به خاطر خداوند عزّ و جلّ به هم مهر ورزند و برای خدا صادقانه
دوستی کنند چونان يك پیکرند، که هرگاه جایی از پیکر یکی به درد آید، دیگری در
همان جا احساس درد می کند .

(بخار الأنوار: ۷/۲۸۱/۷۴)

Hadithi 20

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Nuk duhet që vëllai të jetë më i fortë në
dashurinë e tij (ndaj teje) se ti”.³¹

امام علی علیه السلام:

لا یكونُ أخوکَ أقوى مِنکَ علی مَوَدَّتِهِ .

برادرت در دوستی اش [نسبت به تو] از تو قویتر نباشد.

(بحار الأنوار : ۲۹/۱۶۵/۷۴)

31 “Biharul Enuar”, vëll. 74, Hadithi 7, f. 281.

Hadithi 21

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “O Kumejl! Nëse nuk e do vëllain tënd, atëherë nuk je vëllai i tij”.³²

امام علی علیه السلام:

يَا كُمَيْلُ، إِنْ لَمْ تُحِبِّ أَخَاكَ فَلَسْتَ أَخَاهُ .

ای کئیل! اگر برادرت را دوست نداشته باشی برادر او نیستی .

(تحف العقول : ۱۷۳)

32 “Tuhuful Ukul”, f. 173.

Hadithi 22

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“*Duajini vëllezërit sipas masës së
devotshmërisë së tyre*”.³³

امام علی علیه السلام:

أَحْبِبِ الْإِخْوَانَ عَلَى قَدْرِ التَّوْقَى .

برادران را به اندازه پرهیزکاری آنان دوست مدار .

(الاختصاص : ۲۲۶)

33 “El Ikhtisas”, f. 226.

Hadithi 23

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Dashuria e të drejtit për të drejtin është një shpërblim për të drejtin; dashuria e të pabesit për të drejtin, është një virtyt për të drejtin; urrejtja e të pabesit për të drejtin, është stoli për të drejtin, dhe urrejtja e të drejtit ndaj të pabesit, është turp për të pabesin”.*³⁴

34 “El Ikhtisas”, f. 239.



امام صادق علیه السلام:

حُبُّ الْأَهْرَارِ لِلْأَهْرَارِ قَوَابِلٌ لِلْأَهْرَارِ ، وَحُبُّ الشُّجَارِ لِلْأَهْرَارِ فَضِيلَةٌ لِلْأَهْرَارِ ، وَبُغْضُ الشُّجَارِ لِلْأَهْرَارِ بُغْضٌ لِلْأَهْرَارِ ، وَبُغْضُ الْأَهْرَارِ لِلشُّجَارِ خِزْيٌ عَلَى الشُّجَارِ .
 محبت ورزیدن نیکان به یکدیگر ، پاداشی است برای نیکوکاران و مهر ورزی بدان به نیکان ، فضیلتی است برای نیکان و دشمنی بدان با نیکان ، زیور نیکان است و دشمنی ورزیدن نیکان با بدان ، مایه خواری و رسوایی بدان است .

(الاختصاص : ۲۳۹)

Hadithi 24

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Një nga shenjat e dashurisë së njeriut për fenë
e tij është se ai e do vëllanë e tij”.³⁵

امام صادق عليه السلام:

مِنْ حُبِّ الرَّجُلِ دِينَهُ حُبُّ أَخَاهُ .

از نشانه های دین دوستی آدمی این است که برادرش را دوست داشته باشد.

(الاختصاص : ۳۱)

35 “El Ikhtisas”, f. 31.

Hadithi 25

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Kurrë mos e humb të drejtën e vëllait tënd,
 duke u mbështetur në atë që është mes teje dhe
 atij, sepse atij që ia ke humbur të drejtën, nuk e
 ke më vëlla”.*³⁶

امام علی علیه السلام:

لَا تُضَيِّعْ حَقَّ أَخِيكَ إِكْثَالًا عَلَى مَا بَيْنَكَ وَبَيْنَهُ؛ فَإِنَّهُ لَيْسَ لَكَ بِأَخٍ مِّنْ أَضَعَّتْ حَقَّهُ .
 هیچ گاه حق برادرت را، به اعتماد روابط دوستانه ای که با او داری ضایع نگردان؛
 چه، آن کس که حق او را ضایع می کنی دیگر برادرت نیست .
 (نهج البلاغة: الكتاب ۳۱)

36 “Nehxhul Belaga”, Letra 31.

Hadithi 26

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Këshilla është burim i jetës së miqësisë”.³⁷

امام علی علیه السلام:
العتابُ حياةُ المودة .
گلایه کردن مایه حیات دوستی است .
(غرر الحکم : ۳۱۵)

³⁷ “Gururul Hikem”, f. 315.



Hadithi 27

Imam Zejnel Abedini (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Ruaje gjuhën tënde, që të ruash vëllezërit e tu*”.³⁸

امام زين العابدين عليه السلام:

احْفَظْ عَلَيْكَ لِسَانَكَ تَتْلِيكَ بِهِ إِخْوَانُكَ .

Zbani ra nge dar ta bradrant ra nge dary

(بحار الأنوار : ١/١٥٦/٧٤)

38 “Biharul Enuar”, vëll. 74, Hadithi 1, f. 156.

Hadithi 28

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) transmeton se Harith A'uar i ka thënë Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): “O Prijësi i besimtarëve! Betohem në Allah, se të dua!” Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “O Harith! Nëse vërtet më do, atëherë mos lufto me mua, mos u tall me mua, mos diskuto me mua për t’u dukur, mos bëj shaka me mua dhe mos më çoj më poshtë, ose më lart se sa jam”.³⁹

³⁹ “El Khisal”, vëll. 35, f. 334.



امام صادق علیه السلام: حارث اعور به امیر المؤمنین عرض کرد:

یا امیر المؤمنین، أنا و الله أَجِبُكَ، فَقَالَ لَهُ: یا حارثُ، أما إذا أَحْبَبْتَنِي فلا تُخَاصِمْنِي، و لا تُلاعِبْنِي، و لا تُجَارِينِي حديث ، و لا تُنازِخْنِي، و لا تُواضِعْنِي ، و لا تُرافِعْنِي.
ای امیر مؤمنان! به خدا سوگند که دوستت می دارم. حضرت فرمود: ای حارث! اگر واقعا مرا دوست داری پس سعی کن با من مشاجره نکنی، مرا به بازی نگیری، برای خود نمایی با من بحث نکنی، حدیث با من شوخی نکنی و مرا از آنچه هستم فروتر و یا فراتر نبری .

(الخصال : ۳۵/۳۳۴)

Hadithi 29

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Mos e humb mirësjelljen mes teje dhe vëllait
tënd, qëndro larg prej saj, sepse me humbjen e
mirësjelljes, humbet edhe modestia; ruajtja e
mirësjelljes është vazhdimësia e dashurisë”.⁴⁰

امام صادق عليه السلام:

لَا تُذْهَبِ الْحِشْمَةُ بَيْنَكَ وَبَيْنَ أَخِيكَ وَأَنْتَ مِنْهَا ؛ فَإِنَّ ذَهَابَ الْحِشْمَةِ ذَهَابُ الْحَيَاءِ ، وَ
بَقَاءُ الْحِشْمَةِ بَقَاءُ الْمَوْدَةِ .

ادب و حرمت میان خود و برادرت را از بین نبر و آن را نگه دار؛ زیرا با از بین رفتن
ادب و حرمت، حیا نیز از میان می رود و نگه داشتن ادب و حرمت، مایه پایداری
دوستی است. (تحف العقول : ۳۷۰)

40 “Tuhuful Ukul”, f. 370.

Hadithi 30

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“O biri i Numanit! Nëse dëshiron që dashuria
 e vëllait tënd të jetë e pastër për ty, mos u tall
 me të, mos debato me të, mos u kreno para tij
 dhe mos u grind me të”.*⁴¹

امام صادق عليه السلام:

يَا بَنَ النُّعْمَانِ ، إِنْ أَرَدْتَ أَنْ يَصْفَوْكَ لَكَ وَدُ أَخِيكَ فَلَا تُنَازِحْتَهُ ، وَلَا تُنَازِلْتَهُ ، وَلَا تُبَاهِيْتَهُ ، وَلَا تُشَارِكْتَهُ .

ای پسر نعان! اگر می خواهی محبت برادرت برای تو خالص باشد، هرگز با او شوخی
 [بیجا] مکن، از جدال با او پرهیز، بر او فخر مغروش، و با او ستیزه مکن.

(بحار الأنوار: ۲/۲۹۱/۷۸)

41 “Biharul Enuar”, vëll. 78, Hadithi 2, f. 291.

Hadithi 31

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Vëllezërit kanë nevojë për tri gjëra mes tyre, që, nëse përdoren, miqësia do të zgjasë, përndryshe ata ndahen nga njëri-tjetri dhe bëhen armiq. Ato janë: mirësia, dhembshuria dhe mos të pasurit zili”.⁴²

⁴² “Tuhuful Ukul”, f. 322.



امام صادق علیه السلام:

تَحْتَاجُ الْإِخْوَةَ فِيمَا بَيْنَهُمْ إِلَى ثَلَاثَةِ أَشْيَاءَ ، فَإِنْ اسْتَعْمَلُوهَا وَ إِلَّا تَبَايَنُوا وَ تَبَاعَصُوا ، وَ هِيَ :
الْتِّصَافُ ، وَ التَّرَاحُّمُ ، وَ نَفْيُ الْحَسَدِ .

برادران در میان خود به سه چیز نیازمندند که اگر به کار بندند دوستی می پاید و گرنه
از یکدیگر جدا و دشمن هم می شوند. آن سه چیز اینهاست: انصاف با یکدیگر، مهربانی
با یکدیگر ، و حسد نبردن به هم.

(تحف العقول : ۳۲۲)

Hadithi 32

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Nuk ka përfituar dobi njeriu mysliman, pas dobisë së Islamit, si ajo e vëllait që ka prej Allahut”.⁴³

پیامبر خدا صلی الله علیه و آله:

ما استفادَ امرؤُ مسلمٌ فائدةً بعدَ فائدةِ الإسلامِ مثلَ أخٍ يستفيدُهُ في الله.

انسان مسلمان، بعد از به دست آوردن سود اسلام، سودی همچون برادری که برای خدا به دست می آورد، کسب نکرده است. (تنبیه الخواطر : ۱۷۹/۲)

43 “Tenbijhul Kheuater”, vëll. 2, f. 179.

Hadithi 33

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
*“Të shikosh vëllanë, të cilin e do për hir të Allahut të Madhëruar, është adhurim”.*⁴⁴

پیامبر خدا صلی الله علیه و آله:

النَّظَرُ إِلَى الْأَخِ تَوَدُّهُ فِي اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ عِبَادَةٌ.

نگاه کردن به برادری که به خاطر خداوند عز و جل دوستش می داری، عبادت است.

(بحار الأنوار: ۱/۲۷۹/۷۴)

44 “Biharul Enuar”, vëll. 74, Hadithi 1, f. 279.

Hadithi 34

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Vëllazëria që është për hir të Allahut, jep fryte”.⁴⁵

امام علي عليه السلام:

بِالتَّوَّاحِي فِي اللَّهِ تُثْمِرُ الْأُخُوَّةَ .

با برادری در راه خدا، برادری به بار می نشیند .

(غرر الحکم : ۴۲۲۵)

45 “Gururul Hikem”, f. 4225.

Hadithi 35

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Kush humb një vëlla që e ka për hir të Allahut,
është sikur të ketë humbur gjymtyrën më të
mirë të trupit të tij”*.⁴⁶

امام علی علیه السلام:

مَنْ فَقَدَ أَخَا فِي اللَّهِ فَكَأَنَّمَا فَقَدَ أَعْضَاءَهُ .

Her kështu, bratëri e Allahut është siç është pjesë e trupit të tij.
Dështimi i tij është siç është humbja e pjesëve të tij.

(غرر الحكم: ٩٢٢٧)

⁴⁶ “Gururul Hikem”, f. 9227.

Hadithi 36

Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Kushdo që fiton vëllazërinë vetëm për hir të Allahut dhe në bazë të besimit në Të, dhe besnikërisë ndaj vëllazërisë, ka fituar një rreze drite të Allahut”.⁴⁷

امام باقر عليه السلام:

مَنْ اسْتَفَادَ أَخَا فِي اللَّهِ عَلَى إِيْمَانٍ بِاللَّهِ وَوَقَاءٍ لِأَخِيهِ ، طَلَبًا لِمَرْضَاةِ اللَّهِ ، فَقَدِ اسْتَفَادَ شُعَاعًا مِنْ نُورِ اللَّهِ .

Her kës t'ha për Allahun dhe besnikërisë ndaj vëllazërisë, ka fituar një rreze drite të Allahut.
دست آورد ، پرتوی از نور خدا را به دست آورده است. (تحف العقول : ۲۹۵)

47 “Tuhuful Ukul”, f. 295.

Hadithi 37

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“*Kushdo që fiton një vëlla për hir të Allahut të
Madhëruar, ka fituar një shtëpi në Xhenet*”.⁴⁸

امام رضا عليه السلام:

مَنْ اسْتَفَادَ أَخَا فِي اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ اسْتَفَادَ بَيْتًا فِي الْجَنَّةِ .

هر کس برادری خدایی به دست آورد ، خانه ای در بهشت به دست آورده است .

(ثواب الأعمال : ۱/۱۸۲)

48 “Theuabul A’mal”, vëll. 1, f. 182.

Hadithi 38

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Ruhuni nga ai, miqësia e të cilit nuk është për
hir të Allahut, sepse miqësia e tij është e ulët dhe
shoqëria e tij është e turpshme”.⁴⁹

امام علی علیه السلام:
مَنْ لَمْ يَكُنْ مَوَدَّةً فِي اللَّهِ فَاحْذَرُهُ؛ فَإِنَّ مَوَدَّةَ لَيْئَمَةٍ، وَصُحْبَتَهُ مَشُومَةٌ.
از کسی که دوستی اش برای خدا نیست پرهیز؛ زیرا دوستی او پستی است و
همنشینی با او شوم.
(غرر الحکم: ۸۹۷۸)

49 “Gururul Hikem”, f. 8978.



Hadithi 39

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Të gjitha miqësitë e bazuara te të tjerët, përveç Allahut, janë një mashtrim dhe mbështetja te ata është e gabuar*”.⁵⁰

امام علی علیه السلام:

كُلُّ مَوَدَّةٍ مَبْنِيَّةٍ عَلَى غَيْرِ ذَاتِ اللَّهِ ضَلَالٌ ، وَاعْتِمَادُ عَلَيْهَا مُحَالٌ .

Her دوستی ای که مبنای غیر خدای داشته باشد، گمراهی است و تکیه کردن بر آن
نشاید .

(غرر الحکم : ۶۹۱۵)

⁵⁰ “Gururul Hikem”, f. 6915.

Hadithi 40

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Kushdo që ka vëllazëri për hir të Allahut, ka
fituar dhe, kushdo që ka vëllazëri për hir të kësaj
bote, ka humbur”.⁵¹

امام علی علیه السلام:

مَنْ آخَى فِي اللَّهِ عَيْمًا ، مَنْ آخَى فِي الدُّنْيَا حُرْمًا .

Her që për Allahun bën vëllazëri, për botën bën dëmtim.

مانند. (غرر الحكم : ٧٧٧٦ - ٧٧٧٧)

51 “Gururul Hikem”, f. 7776-7777.



اسم الكتاب: اربعون حديث عن الإخوة الإسلامية

ترجمة الأحاديث: صبريه فزا

تحت النظر: الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الإخراج النهائي: صبريه فزا

الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعية نسيم

تيرانا: 2022